

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Interpelanca me ministren - Spahia në Kuvend: Operatori i Shërbimeve të Integruara, skemë korruptive p ër të grabitur miliona euro
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917346/spahia-interpelance-me-ministren-e-shendetesise-ope ratori-i-sherbimeve-te-integruara-skeme-korruptive-per-te-grabitur-miliona-euro/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:29:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:23:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a68db242d1adc09182a5a729519811520bed54e7ffb6caf60fe8cb2bc7f8482
TEKSTI	a8a72fbdad864bbb1efccb9a5bb1e291d276d0c1c5ba575160a527cc7d767318
PAMJA	dbc7f48ec2339664b648d3c0cd0bcaefb1ab21b0bb5d8f99e305855f245dd3d6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6dfd0e48624717ecc62fbca8cfb145c7c4f32e649cad9d02c283cc557215f1a7
E MËPARSHMJA	b2e67508300ba3333a6d3c815b00b43457a30d97288f4b2bc78e82d0b173e8f4
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/6dfd0e48624717ecc62fbca8cfb145c7c4f32e649cad9d02c283cc557215f1a7

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

LAJMI I FUNDIT

LIVE - Seanca plenare

më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti:
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli



Spahia në Kuvend: Operatori i Shërbimeve të Integruara, skemë korruptive për të grabitur miliona euro

14:23, 17/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Deputeti i Partisë Demokratike, njëherësh kryetar i komisionit për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale, Bardh Spahia, thirrur sot në interpelancë urgjente me ministrin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahi, në lidhje me krijimin e Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësor.

Spahia theksoi se Operatori i Shërbimeve të Integruara Shëndetësore, nuk është asgjë tjetër, përveçse një mënyrë e re për të grabitur qindra miliona euro të destinuar për pacientët shqiptarë.

Emërimi i ministres së re zonja Spahi u cila pa mbushur javën zbatoi urdhrin e shefit të saj të emëronte në krye të kësaj structure të re njeriun e afërt të Linda Ramës, bashkëshortes së kryeministrit Rama, ishte konfirmim i kësaj skeme të re korruptive.

Bardhi tha se agjencia u krijua në mungesë të plotë llogaridhënie e transparence.

“E krijuat këtë agjenci në mungesë të plotë llogaridhënie dhe transparence, pa sqaruar aspak se si kompetencat që janë sot të ndara midis disa institucioneve me krijimin e këtij operatori do të centralizohen duke u bërë njëkohësisht blerës, depo qendrore, operator logjistik, administrator i rezervave, si dhe duke i dhënë kompetenca për të krijuar dhe kompani të tjera bija. Kjo ngre pyetje serioze juridike përtej kalimit apo mbivendosjes së kompetencave që ligji u ka dhënë institucioneve si Ministrisë së Shëndetësisë, FSDKSH-ja, AKBPM-ja dhe Operatori i Blerjeve të Përqëndruara. dhe operatori të blerjeve të përqëndruara. Është e papranueshme që sistemi shëndetësor të funksionojë mbi një model ku blerja, magazinimi, logjistika, furnizimi dhe administrimi i shërbimeve jetike përqendrohen në një dorë të vetme. Kjo që po bëni ju sot nuk gjendet në asnjë vend tjetër të Bashkimit European. Ndaj, Ministria e

Shëndetësisë do të duhet të sqarojë urgjentisht bazën ligjore, kompetencat, fondet dhe mekanizmat e kontrollit që do të ketë kjo megastrukturë", tha ai.

Gjithashtu, tha Spahiu, ministria "sot do t'ju përgjigjet shqiptarëve për të gjitha premtimet boshe që ish-parardhësja e saj ka bërë në fillim të vitit për shërbimin onkologjik, ndërkohë që situata sot vazhdon të paraqitet dramatike në rang kombëtar"

"Aktualisht ka ende mungesa dhe akses të kufizuar në shërbime bazë, diagnostikuese dhe terapeutike për pacientët onkologjikë, si PET skaneri, akselerator linear dhe brakiterapia. Ministria e Shëndetësisë ka deklaruar publikisht se PET skaner dhe brakiterapia do të ofrohen brenda vitit 2026. Për pacientët e familjet e tyre përcaktimi brenda vitit nuk është i mjaftueshëm. Kërkohej një afat konkret dhe në çfarë date pacientët do të mund të marrin këto shërbime në sektorin publik pa qenë të detyruar ti kërkojnë jashtë vendit apo në sektorin privat. Pyetja është ku shkojnë paratë? Sepse shqiptarët vijojnë të mos marrin shpenzimin minimal për nevojat e tyre.

Bardhi theksoi se qeveria Rama po vijon të krijojë "skema korruptive për të grabitur miliona euro, ndërkohë që shqiptarët vdesin nga babëzia juaj".

© SYRI.net

Lexo edhe:



Skandali 'KAYO'/ Berisha: Çdo përpjekje për të paraqitur rrezikshmërinë e lartë që ky person paraqet për NATO




Berisha: Lau duart si Ponc Pilati. Rama përdori Bordin e Paqes për të shpëlarë 'krimin e shëmtuar' ndaj Kosovës



Berisha: Kontrabandë e mirëfilltë. Blihen armë në zona lufte, Shqipëria paraqitet si vend prodhues

mon pjesë dhe mikujat kryejten e tyre



Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versionin i ri i pakonsultuar me asnjë...



Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhdukët historia



'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

TË NGJASHME



Berisha-ministres së Shëndetësisë: Shko e pi kafe me Karçanajn të mbledhësh mendjen! Jep dorëheqjen, ke futur Lindën e Surrelit aty



Balliu në Kuvend: Në një shtet normal prevalon Kushtetuta, në një narkoshtet prevalon vendimi i partisë



Protesta te Kuvendi/ Narko-policia arrestoi me dhunë 11 protestues



VIDEO/ Nuk ndalet revolta qytetare, policia arreston protestuesin simbol, 'djalin e pankartës'



Berisha: Aleksandër Vuçiç dhe argati i tij Edi Rama janë përgjegjës direkt për atë që ndodhi në Hagë



VIDEO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave, narko-policia u sulet qytetarëve



Protesta në Prishtinë/ Studentët kërkojnë drejtësi për ish-krerët e UÇK-së

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net